



**NGRITJA
E ZËRIT**

Tel: 044 195-113
044 633-325
Adresa: Rruga e UÇK-së,
Skenderaj
Email: info@ngritjaezerit.org
Web: www.ngritjaezerit.org

GJYKATES KOMUNALE NE SKENDERAJ

PADITES: Mustaf Mustafa , nga fshati Ticë , 41000 Skenderaj, Republika e Kosovës

E PADITUR: REPUBLIKA E SERBISË –Qeveria e R.S. rr. e Nemanjës
nr.11 11000 Beograd

PADI PER KOMPENZIM DEMI

Propozim për lirim nga pagimi i shpenzimeve procedurale (sipas nenit 7 te Udhëzimit Administrativ nga K.GJ. 2008/02 dhe neni 468.1 te Ligji Nr. 03/L-006)

Objekt kontesti : Kompensimi dëmit

Vlera e kontestit : 2799450€

1.) Paditësit me datën 16.05. 1999 afër shtëpisë nga forcat serbe i është vrarë nëna Maliqe Mustafa viti i lindjes 1923 , bashkëshortja Shehide M., viti i lindjes 1963 Vajzat Halime , viti i lindjes 1984 dhe Vjollca Mustafa , viti i lindjes 1987 ndërsa djali Brahim Mustafa është mbajtur tri javë ne burgun e Smrekovnicës , është torturuar ne mënyrë mizore , gjithashtu edhe djali tij Sylë Mustafa është maltretuar dhe ka pësuar çrregullime psikike .

Provë : - Vërtetimet nga D.SH.M.S. 09 Nr. 580 te datës 20. 01.2009

- Kërkesa për kompensimin e dëmeve te luftës , e dt.20.01.2009 nr. 580-67

- Raporti specialistit 30.06.2009

- Fotografit e personave të vdekur

- Vërtetimi i KMDLNJ , nr. 125/2003 06 - 02 2003

Certifikata mbi te drejtat e pronës së paluajtshme, UL-72015068 - 00025 e datës 16.01.2009

2.) Paditësi se bashku me 7 anëtarët e familjes është detyruar ta braktis shtëpinë dhe ka qëndruar në shtëpinë e Isa Kurtit në Skenderaj 3 muaj , në Baks te Adem Rrypi 2 muaj , në Tushilë në male 4 muaj , në Mitrovicë të Xhemal Ademi 3 muaj , ndërsa në shtëpi është kthyer me dt. 12.06.1999 , i është djegur shtëpia 64 metër katror , interieri shtëpiak , nuk ka mundur ta punoj token (3 hektar e 20 ari) për dy vite i është vjedhur traktori me rimorkio vetura Opel Askona , dy lopë , 1 viç , dhe qeni , i është djegur hamari me drithë me 200 kg grurë , koshi i misrit garazha dhe ushqimi për kafshë .

Provë : Deklarata për bashkësinë familjare nenë numrin rendor 035/3213 e datës 16.01.2009

Vërtetimi I Drejtorisë së Urbanizmit,325-64 i datës 16.01.2009

3.) Padiësi si rezultat i vendimit politik është larguar nga vendi i punës me dt. 01.01.1990

Provë : Vërtetimi i Shkollës Fillore „ 2 Korriku ” në Ticë

Provë : - Dëgjimi i padiësit anëtarëve tjer të familjës dhe provave të tjera të cilat padiësi do të prezantoj në seancat e shqyrtimit kryesor dhe në rast nevojë të caktohet edhe eksperti përkatës.

4.) Të drejtën për kompensim padiësi e bazon në nenin 185 të LMD (G. Z. e RSFJ , Nr. 29 /78) në lidhje me nenin 180.1 të të njëjtit Ligj , me të cilin është paraparë që për demin e shkaktuar ndaj pasurisë të personave fizik si rezultat i dhunës dhe terrorit , përgjegjëse është „ Bashkia shoqërore politike ” e në këtë rast e paditura ka qenë e obliguar të pengoj aktet e vrasjes , dhunës , terrorit , dëmtimit , asgjësimit dhe vjedhjes së pasurisë së padiëses .

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (neni 1 Protokollin nr. 1 , neni 2 dhe protokollin nr. 6 , neni 3 , neni 5 (5) , neni 10 dhe neni 14) .

Padiësi propozon që kjo Gjykatë të caktoj shqyrtimin kryesor të çështjes , t'i shfrytëzoj informatat e duhura nga mjetet provuese të propozuara dhe

1.) pastaj të bëjë këtë :

AKTGJYKIM

I. Aprovohet kërkesë padia e padiësit Mustafë Mustafa nga fshati Ticë , 41000 Skenderajt Republika e Kosovës në tërësi si e bazuar .

II. Obligohet e paditura Qeveria e Serbisë si pasardhëse juridike e Qeverisë së më parshme që në emër të të njëjtës të kompensojë demin material dhe jo material padiësit Mustafë Mustafa ,nga f.sh.Ticë, 41000 Skenderajt Republika e Kosovës, duke ja paguar :

- shumën prej 2 400 000 € për vrasjen nënës Maliqe Mustafa , bashkëshortes Shehide , vajzat Halime dhe Vjollca Mustafa
- shumën prej 150 000 € për çrregullimin psikik të fëmijut Sylë Mustafa
- shumën prej 84 000 € për dhembjen shpirtërore dhe të munduarit , ndjekjes nga shtëpia , banimi në qiell të hapur dhe shtëpi të huaja në kohëzgjatje prej 4 muaj e një javë
- shumën prej 50 000 € për shkak të pamundësuarit e krenimit të festave fetare në shtëpi , vizitën dhe nderimin e varrezave , humbjes së kontaktit me farefis dhe të afërmit
- shumën prej 20250 € për largimin nga puna si rezultat i vendimit politik
- shumën prej 64 000 € për shtëpinë e djegur dhe të shkatërruar,
- shumën prej 7000 € për tërë teknikën e bardhë në sallën dhe mobilerin e 3 dhomave të gjumit.
- shumën prej 7200 € për pamundësimin e shfrytëzimit të tokës bujqësore për tri vite
- shumën prej 8200 € për Traktorin me rimorkio
- shumën prej 1500 € për veturën
- shumën prej 2800 € për 2 lopë , 1 viç dhe qenin
- shumën prej 4500 € për hamarin me drithë , koshin e misrit garazha dhe ushqimin e kafshëve .

te gjitha këto shuma me kamat ligjore qe nga dita e ngritjes se padisë e deri ne ditën e pagesës definitive të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se aktgjykimit , nen kërcënim te përmbarimit te dhunshëm .


Pala e paditur te paguaj shpenzimet procedurale te kësaj çështje juridike në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se aktgjykimit, nen kërcënim te përmbarimit te dhunshëm .

1.) të bihet :

AKTVENDIM

Mbi miratimin e propozimit te paditëses në ter çështjen juridike mbi lirimin nga pagimi i taksave dhe shpenzimeve tjera procedurale duke marr parasysh gjendjen e vështir ekonomike te paditëses ne kuptim me nenin te Udhëzimit Administrativ nga K.GJ. 2008/02 dhe neni 468.1 te Ligji Nr. 03/L-006 .

Skenderaj , me dt. 03.05.2010

Paditësi
Mustafë Mustafa


Shtojcë ;

1. Vërtetimet nga D.SH.M.S. 09 Nr. 580 te datës 20. 01.2009
2. Kërkesa për kompensimin e dëmeve te luftës , e dt.20.01.2009 nr. 580-67
3. Raporti specialistit 30.06.2009
- 4..Fotografit e personave të vdekur
5. Vërtetimi i KMDLNJ , nr. 125/2003 06 - 02 2003
6. Certifikata mbi te drejtat e pronës së paluajtshme, UL-72015068 - 00025 e datës 16.01.2009
7. Vërtetimi i Shkollës Fillore ,, 2 Korriku '' në Ticë
8. Vërtetimi I Drejtorisë së Urbanizmit,325-64 i datës 16.01.2009
9. 4 kopje te padisë